



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

**RAPORT MBI
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT
NR. 01/2019**

03 maj 2019

I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren e AAC-së, si në vijim:

- RREGULLORE (AAC) Nr. xx/2019 PËR SHËNJIMIN E PENGESAVE

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik sipas kërkesave të nenit 5, pika 5.2 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012, përkatësisht nga data 20 mars deri më 19 prill 2019.

Neni 5, Pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 thotë që:

“AAC-ja do të aplikojë procedura transparente për konsultimit publik të palëve të interesuara nëpërmes:

- a) Metodës së pranimit të komenteve dhe vërejtjeve me shkrim me anë të mjeteve elektronike të komunikimit (adresë elektronike zyrtare) apo dorëzimit të tyre personalisht ; dhe/ose
- b) Organizimit të takimeve publike me palët e interesuar”

Në rastin e kësaj rregulloreje konsultimi publike me palët e interesuara, u realizua sipas pikës 5.1, a) të udhëzimit të lartëcekur.

II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Thirrjes së dërguar për konsultim publik të palëve të interesit i është përgjigjur një person, i cili ka paraqitur sugjerimet e tij nëpërmes postës elektronike zyrtare të AAC-së. Në vijim janë të pasqyruara vërejtjet/sugjerimet e pranuar në formë origjinale siç janë dërguar dhe pranuar në AAC për projekt-rregulloren e lartpërmendur, ndërsa në formë të përmbledhur janë paraqitur përgjigjet e AAC-së.

Komenti i parë:

“I already reviewed the planned regulation for obstacle marking sent by you, I attached the document with my only remark. The document is very detailed and worked out well, I have just one suggestion for that, to make a bit more understandable to people not being specialist in aviation issues, like people working in constructions, or Electric companies etc.. It would be good to include some example in the regulation for light types, and make visible how it would be placed at the obstacles. In that case I also attached some example to make this regulation a bit more clear and practical. Thank you for involving us in this process it is our honour to do that. I wish you nice day and successful process with this regulation.”

Përgjigje e AAC-së:

Rregullorja është në përputhje të plotë me kërkesat e EASA dhe ICAO, në veçanti me Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 139/2014 që përcakton kërkesat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet në përputhje me Rregulloren bazë të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e transpozuar në rendin ligjor të RKS përmes Rregullores 17/2017 me të njëjtin emër. Shembujt e propozuar mund të përdoren si material orientues për industrinë, si pjesë e publikimit teknik dhe të materialeve udhëzuese.

Komenti i dytë:

Në nenin 7.6 (a) “yellow for the servicing vehicles.” *Perhaps it is accidentally here twice.*

Përgjigje e AAC-së:

Pranohet. Teksti i panevojshëm në nenin 7.6 (a) të Rregullores do të fshihet.

(Dërguar nga Sandor NAGY, Zyrtar për Menaxhim të Sigurisë - KFOR Aeroporti Ushtarak Prishtinë, dt. 26 mars 2019, ora 10:06 min).

III. PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me projekt-rregulloren, janë vlerësuar gjithsej 2 vërejtje/komente me shkrim të cilat janë pranuar nga 20 mars deri më 19 prill 2019.

Nga këto vërejtje/komente, AAC-ja ka pranuar një (1) vërejtje për adaptim/përmirësim të tekstit të rregullores (komenti nr.2) i cili do të përmirësohet në verzionin përfundimtar të Rregullores. Komenti tjetër ka marrë përgjigjen adekuate.

Raporti është hartuar nga:

Departamenti i Aerodromeve
Zyra për Çështje Ligjore të Aviacionit